



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.208 dt.29.09.2000

**PER  
DHENIE TITULLI "MIRENJOHJE E QYTETIT"**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.29.09.2000, pasi mori në shqyrtim relacionet e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Arsimit për miratim titulli "Mirënjohje e Qytetit" dhe propozimin e një grupi të këshilltarëve për dhënien e këtij titulli anëtarit të Këshillit Bashkiak Kristaq Kume, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor" në Republikën e Shqipërisë dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.137, dt.30.07.1999 "Miratimi i titujve vlerësues të Bashkisë së Tiranës"

**V E N D O S I**

1. Të miratojë dhënien e titullit "Mirënjohje e Qytetit" intelektualit të njohur **Prof. Dr. Kristaq Kume**, me këtë motivacion:

**"Intelektual i shquar që ka dhënë kontribut të dallueshëm në kërkimin shkencor në blegtorinë shqiptare dhe që, me përkushtim, ndershmëri dhe ndjenjë të lartë patriotike ka kontribuar në zhvillimin e proceseve demokratike në vendin tonë"**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe ajo e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**